



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 15
30.04.2015

NR. VENDIMI 11
04.05.2015

V E N D I M

«Për Sekuestrim Pasurie»

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej

GJYQTARE: Liljana BAKU

Asistuar nga sekretare séance **Alma RAMAJ**, sot në datë 04.05.2015, ora 10.00
mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, kërkesën penale Nr.15 Regj. me:

KËRKUESE:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë,
përfaqësuar nga **prokurori Gentian TRENOVA**.

KUNDËR SHTETASVE:

1. K.I., i biri i xxx dhe i xxx, i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në xxx, Rruga
“xxx”, Pallati Nr.xxx.

2. D.I., i biri i xxx dhe i xxx, i datëlindjes xxx, lindur në xxx dhe banues në
xxx.

KUNDËR SHOOËRISË: “xxx”.

OBJEKTI:

1. Sekuestrimin e llogarive si më poshtë:

Llogari me Nr.xxx, në Bankën e xxx, xxx, në vlerën
xxx (xxx mijë) lekë, me afat një vjeçar nga data xxx deri në datë xxx, në emër të
shtetasit **D.I.**, i biri i

xxx dhe i xxx, i datëlindjes xxx.

Depozitë me Nr.xxx në Bankën xxx, në emër të shtetasit **K.I.**, në vlerën xxx (xxx) lekë.

Depozitë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të shtetasit **K.I.**, në vlerën xxx (xxx) lekë.

Llogari rrjedhëse në dollarë amerikanë, me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të Shoqërisë “xxx”, në vlerën xxx (xxx) dollarë.

2. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit Gjyqësor xxx, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive të sekuestruara, Znj.E.O.(P.), administratore në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave xxx.

BAZA LIGJORE:

Nenet 3 pika 1 gërma “d”, 3 pika 2 gërma “a”, 3 pika 4 deri në 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 «Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë».

Në përfundim të gjykimit, gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur, mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi dëgjoji diskutimin përfundimtar të prokurorit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx, në datë xxx, regjistroi procedimin pasuror Nr.xxx, Viti xxx, në ngarkim të shtetasit K.D.I., si person i dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Procedimi pasuror ishte rrjedhojë e procedimit penal Nr.xxx, Viti xxx, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx.

Nga materiali hetimor, që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx i dërgoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

xxx, rezultoi sa më poshtë:

Sektor i Krimin Ekonomik dhe Financiar, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut xxx, siguroi informacione për kryerje të investimeve të shumave të mëdha të parave, në pasuri të palujtëshme, nga shtetasi K.I. dhe Shoqëria «xxx», për të cilat u dyshua se e kishin burimin nga aktivitete të paligjshme kriminale. Më konkretisht: Në favor të Shoqërisë «xxx», në periudhën xxx-xxx, në Bankën “xxx” (aktualisht “xxx”) ishin transferuar shumat totale xxx USD dhe xxx Euro, të dërguara, pjesa më e madhe e tyre nga Shoqëria «xxx», me qendër në xxx, një pjesë nga «xxx», me qendër në xxx dhe, një pjesë nga «xxx», me qendër po në xxx.

Shtetasi K.I., një pjesë të fondeve të përfituara sa më sipër, në shumën prej xxx USD, në shuma të ndryshme, e transferoi në kompani dhe persona të ndryshëm, në shtete të ndryshme të njohura si parajsë fiskale, duke i paraqitur si pagesa për studime fizibiliteti në projekte minierash, shërbime ligjore, shpenzime zyresh, konsulencë, shpenzime udhëtimi etj.

Në periudhën xxx-xxx, Shoqëria «xxx» përfitoi xxx USD nga «xxx” dhe xxx nga «xxx”, për likuidim detyrimesh.

Gjithashtu, rezultuan informacione për transaksione me anomali të kryera në emër të Shoqërisë «xxx”, Dega Shqipëri (xxx), krijuar në xxx, me përfaqësues ligjor shtetasin K.I.

Ndërsa të ardhurat e shoqërive të K.I. rezultonin zero, nga verifikimet e bëra në emër të tij dhe familjarëve, rezultuan transaksione vetëm në emër të V. I. dhe L.I. e, konkretisht:

Në datë xxx, V.I. depozitoi xxx Euro dhe, po në këtë datë, tërhoqi xxx Euro. Në datë xxx, shtetasja L.I. lidhi Kontratë Shitblerje Nr.xxx Rep. Nr.xxx Kol. (noter Gj.K.) me rezervë, pasuri të palujtëshme, truall, me sipërfaqe xxx m², ndodhur në xxx, me palë blerëse Shoqëria «xxx» Sh.P.K. Në datë xxx, L.I. lidhi kontratë premtim shitje pasurie Nr.xxx Rep. Nr.xxx Kol. (noter Gj. K.), në vlerë xxx Euro, për truallin me sipërfaqe xxx m², ndodhur tek xxx, me palë blerëse R.L. L. Në datë xxx, L. I. tërhoqi shumën prej xxx Euro.

Për Shoqërinë «xxx», në Bankën “xxx

xxx” u kryen transaksionet e mëposhtme:

Në periudhën xxx-xxx, shuma prej xxx Euro u vendos në depozita mujore të vazhdueshme dhe interesat u tërhoqën kryesisht nga K.I. ose u transferuan në favor të tij, për shlyerje kartë krediti, në një total prej xxx Euro. Gjatë të njëjtës periudhë, u transferua, në favor të R.G., shuma prej xxx Euro, për pagesë kartë krediti.

Në datë xxx, u maturua depozita me afat në vlerën xxx Euro, e cila u rivendos përsëri në depozitë me afat, në mënyrë të vazhdueshme, së bashku me interesat e përfituara. Në datë xxx, u transferua shuma prej xxx Euro në llogarinë e Shoqërisë “xxx Bank”. Në periudhën xxx-xxx, u kryen 20 transferta, në favor të M.Sh., në vlerë totale xxx Euro. Në datë xxx, K.I. tërhoqi shumën prej xxx Euro dhe, në këtë datë, gjendja në llogari ishte xxx Euro dhe, në depozitë xxx Euro. Në numrin e llogarisë në USD (xxx) në periudhën xxx-xxx, u përfituan transferta mujore në vlerë totale xxx USD nga “xxx”, në vlerë totale xxx USD, të cilat u vendosën kryesisht në depozita me afat, duke patur edhe transferta dhe tërheqje, konkretisht: në favor të R.G. xxx; K.I., tërheqje dhe transferta për kartë krediti, xxx USD, “xxx” xxx USD; xxx, Dr.C. S., L.B., L. etj, në shumën totale xxx USD.

Gjendja në llogari, në datë xxx, ishte xxx USD; në datë xxx u maturua depozita në vlerë xxx USD, në datë xxx u maturua në vlerë xxx USD, në datë xxx u maturua në shumën xxx USD, në datë xxx u maturua në shumën xxx USD, në datë xxx, në shumën xxx USD, në datë xxx në shumën xxx USD dhe, në datë xxx në shumën xxx USD, në vlerë totale të depozitave xxx USD.

Në datë xxx, shuma prej xxx USD u transferua në favor të “xxx”, në formën e dhënies hua me afat të shkurtër; në datë xxx u transferua shuma prej xxx USD në llogarinë tjetër në USD në të njëjtën bankë; në datë xxx, llogaria u kreditua për xxx USD e transferuar nga llogaria tjetër në USD pranë të njëjtës bankë; në datë xxx, të gjitha fondet u vendosën në një depozitë me vlerën xxx USD; në datë xxx u transferua tek llogaria tjetër në USD shuma prej xxx USD, u kryhen tërheqje apo transferta në favor të K.I. në shumën xxx Euro dhe xxx USD si dhe, në favor të M.Sh. në shumat xxx Euro dhe xxx USD.

Nga llogaritë e Shoqërisë «xxx» u kryhen

transferta edhe në favor të shoqërive të tjera ku K.I. figuronte administrator, si në favor të “xxx” në total xxx USD dhe të “xxx” SH.P.K në total xxx USD.

Gjendja në llogarinë e Shoqërisë pranë “xxx”, në datë xxx në total, në llogari rrjedhëse ishte xxx USD dhe xxx Euro dhe, në depozita me afat në shumat xxx USD dhe xxx Euro.

Nga Drejtoria Kundër Pastrimit të Parave, u dha informacioni se edhe Shoqëria “xxx” ishte e dyshuar dhe nën hetim në lidhje me transaksionet, në vlera të konsiderueshme, të kryera në llogaritë e saj.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx ngriti dyshime në lidhje me burimin e fondeve dhe aktivitetin e kryer sa më sipër dhe regjistroi procedimin penal, duke vazhduar hetimet për llogari të tij. Në kuadër të hetimit paraprak, mbi kërkesën e organit procedues, Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx, me Vendimin Nr.xxx datë xxx, vendosi masën e sekuestros mbi shumat e parave të ndodhura në llogaritë e Shoqërisë «xxx», me Nr.Nipri xxx, pranë Bankës “xxx” dhe, mbi shumat e parave të ndodhura në llogaritë e shtetasit K.I., pranë kësaj banke. Gjithashtu, pasi çmoi se ndodhej para rasteve të parashikuara nga Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, materialin hetimor i’a kaloi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx.

Me marrjen e akteve nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx, në vlerësim të tyre, arsyetoi se llogaritë në emër të shoqërive dhe shtetasit K.I. dyshohej se ishin produkte të veprës penale për të cilën, ky i fundit, ishte në hetim e sipër. Sipas saj, shtetasi K.I. ishte subjekt i hetimit pasuror, në zbatim të nenit 3 pika 1 gërma “d” të Ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” pasi po hetohej për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Pas ekzekutimit të masës së sekuestros, vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx, për subjektin Shoqëria “xxx”, rezultuan të bllokuara llogaritë rrjedhëse në USD në shumat xxx; në Euro në shumat xxx dhe depozitat: në USD xxx; në USD xxx; në USD xxx; në USD xxx; në USD xxx; në Euro xxx; në Euro

xxx dhe në Euro xxx, ndërsa për shtetasin K.I. llogaritë me balanca në USD xxx dhe në Euro xxx. Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx, me Vendimin Nr.xxx datë

xxx, në zbatim të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009, vendosi masën e sekuestros mbi pasuritë e përshkruara më sipër.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, me Shkresën nr.xxx Prot, datë xxx, përcolli në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx, krahas dokumentave të tjera, Shkresën Nr.xxx Prot, datë xxx, të Bankës “xxx” ku konfirmohej sekuestrimi i llogarive bankare të sipërcituara; Vendimin Nr.xxx datë xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx mbi sekuestrimin e parave të ndodhura në llogaritë e Shoqërisë “xxx, me Nr.Nipti xxx, në të gjitha bankat e nivelit të dytë dhe sekuestrimin e parave të ndodhura në llogaritë e shtetasit K.D. I., në të gjitha bankat e nivelit të dytë si dhe; Shkresën Nr.xxx datë xxx, të Bankës “xxx Albania”, sipas të cilës shtetasi K.I. kishte, pranë saj, llogarinë rrjedhëse individuale, në monedhën në Lekë, me numër xxx, me balancë xxx, e cila ishte e bllokuar.

Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx, me Vendimin Nr.xxx datë xxx, vendosi masën e sekuestros mbi llogarinë rrjedhëse individuale, në monedhën në Lekë, me Nr.xxx dhe balancë xxx, të ndodhur në Bankën “xxx”.

Në kuadër të hetimit të procedimit pasuror Nr.xxx, Viti xxx, rezultoi se shtetasi K.I. kishte llogari bankare në Bankën “xxx Bank”, ndërsa babai i tij, shtetasi D.I., kishte llogari, në xxx, në Bankën e xxx.

Ndërsa për llogaritë bankare të Shoqërisë “xxx” dhe të shtetasit K.I., për të cilat, me vendim gjykata, u vendos masa e sekuestros, organi procedues (prokuroria), në datë xxx, konkludoi nevojën e konfiskimit të tyre dhe paraqiti, në gjykatë, kërkesën me të njëjtin objekt, për llogaritë bankare, në Bankën “xxx Bank” dhe për llogarinë, në xxx, në Bankën e xxx, në emër të shtetasit D.I., regjistroi procedimin pasuror Nr.xxx, Viti xxx.

Informacioni për llogarinë, në xxx, u mor, nga Banka e xxx, me Shkresën Nr.xxx Prot. datë xxx, sipas të cilës shtetasi D. I., i biri i xxx dhe i xxx, i datëlindjes xxx, zotëronte, pranë kësaj banke, llogarinë me Nr.xxx, në xxx, në vlerën xxx (xxx mijë) lekë, me afat një vjeçar, nga data xxx deri në datë xxx.

Informacioni për llogaritë e shtetasit K.I. në Bankën “xxx Bank”, u mor prej kësaj të fundit, me Shkresën Nr.xxx Prot. datë xxx, sipas të cilës shtetasi K.I. zotëronte llogaritë bankare: Depozitë me

Nr.xxx, në vlerë xxx (xxx) lekë; Depozitë me Nr.xxx, në vlerë xxx (xxx) lekë dhe llogari rrjedhëse, në dollarë amerikanë, me Nr.xxxx, në emër të Shoqërisë “xxx”, në vlerë xxx (xxx) dollarë.

Në datë xxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx paraqiti, para kësaj Gjykate, kërkesën me objekt sekuestrimin e llogarive, të përshkruara më sipër, duke patur si bazë ligjore Ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të Ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesëditor, të parashikuar në këtë dispozitë, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, kërkesën e paraqitur.

Në kërkesë dhe në seancë gjyqësore prokurori i qëndroi pretendimeve në lidhje me dyshimet e ngritura për shtetasin K.I., duke pretenduar se ekzistonte rreziku i tjetërsimit të pasurisë objekt sekuestrimi.

Në funksion të provueshmërisë së pretendimeve dhe kërkesës në gjykim, prokurori paraqiti si provë aktet që kishin të bënin me regjistrimin e procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, aktet për regjistrimin e procedimeve pasurore Nr.xxx, Viti xxx dhe Nr.xxx, Viti xxx, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx, informacionet, vendimet gjyqësore dhe kërkesën me objekt konfiskimin e llogarive bankare të sekuestruara paraprakisht.

Gjykata, në analizë të pretendimeve të prokurorit dhe provave të paraqitura prej tij, çmon se kërkesa është e drejtë, e bazuar ligj dhe prova dhe, si e tillë, duhet të pranohet për këto arsye:

I. Kërkesa u paraqit në zbatim të nenit 3 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të titulluar “Fusha e zbatimit”.

Në pikën 1 gërma “d” të Ligjit parashikohet zbatimi i tij për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje, për kryerjen prej tyre të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ndërsa në pikën 2 gërma “a” të tij, zbatimi edhe mbi pasuritë e personave të afërm të subjektit të pikës 1.

U provua në gjykim se shtetasi K.I. është shtetas nën hetim për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, për të cilën

është duke proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx. Për pasojë, ai është subjekt i zbatimit të Ligjit, për shkak të dyshimeve dhe hetimeve që rëndojnë mbi të dhe pasuria e tij i nënshtrohet masave parandaluese të parashikuara në këtë ligj. Shtetasi D.I., babai i shtetasit nën hetim K. I., është subjekt i zbatimit të ligjit për shkak të qënies së tij person i afërm me këtë shtetas.

II. Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të Ligjit, gjykata çmon se për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasurinë është e domosdoshme ekzistenca njëkohësisht e dy kriterëve të përgjithshme që kanë të bëjnë me: **1.** Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. të bazuar në indicje. që tregojnë se personat mund të jenë të përfshirë në veprimtari kriminale. **2.** Zotërimin e pasurive dhe të ardhurave që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe ekzistenca e të paktën njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Sa më sipër, u arsyetua se mbi shtetasin K.I. rëndon dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicje, për përfshirje të tij në veprimtarinë kriminale të pastrimit të parave, që është një prej veprave penale që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit.

Shtetasi K.I. dhe familjarët e tij, duke përfshirë edhe shtetasin D. I., nuk rezultojnë me të ardhura të ligjshme, që të mund të justifikohen pasuritë e konsiderueshme në zotërim të tyre (kriteri 2 i përgjithshëm).

Ekziston rreziku real për tjetërsimin e pasurive objekt sekuestrimi. Në kushtet e qënies së shtetasve K.I dhe D.I., si subjekte të procedimit pasuror dhe marrjes dijeni për masat parandaluese, të vendosura mbi pasuritë e disponuara prej tyre, ekziston rreziku që këta shtetas të bëjnë të gjitha përpjekjet, me qëllim shmangien e pasurive nga një konfiskim i mundshëm (kriteri i veçantë i parashikuar në gjermën “a” të pikës 1 të nenit 11).

Në bazë të pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi u vlerësua prania e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, për vendosjen e masës së sekuestros, gjykata çmon se ekziston detyrimi që të njoftojë zotëruesit e pasurive të sekuestruara, për vendimin e marrë prej saj. Në zbatim të kësaj dispozite, për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën e paraqitur të drejtë dhe ligjore, vendimi i saj duhet t’u njoftohet shtetasit nën hetim K. I. dhe babait të tij, shtetasit D.I.

Në bazë të pikës 3 të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të Ligjit në fjalë, kompetente për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të pasurive janë

përmbaruesit gjyqësorë dhe, për administrimin e tyre administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Në këto kushte, është detyrim ligjor për gjykatën që, në vendimin e saj, të urdhërojë zyrën e përmbarimit, në juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e luajtshme (neni 516 i Kodit të Procedurës Civile) dhe, një administrator të agjensisë, të cilët do të koordinojnë punën për zbatimin e vendimit të sekuestros.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d”, nenit 5 pika 3, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma “a”, nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

V E N D O S

Pranimin e kërkesës, vendosjen e masës së sekuestros mbi:

Llogarinë, me Nr.xxxx, në Bankën e xxx, në xxx, me vlerë xxx (xxx) lekë, me afat një vjeçar nga data xxx deri në datë xxx, në emër të shtetasit D.I., i biri i xxx dhe i xxx, i datëlindjes xxx.

Depozitën, me Nr.xxx, në Bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit K.I., me vlerë xxx (xxx) Lekë.

Depozitën, me Nr.xxx, në Bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit K.I., me vlerë xxx (xxx) lekë.

Llogarinë rrjedhëse, në dollarë amerikanë, me Nr.xxx, në Bankën “xxx Bank”, në emër të Shoqërisë “xxx”, me përfaqësues ligjor shtetasin K. I., me vlerë xxx (xxx) dollarë.

Për ekzekutimin e vendimit të sekuestros, ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxx dhe, për administrimin e pasurive të sekuestruara, administratorja E.O. (P.), në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave xxx.

Urdhërohet K/Sekretaria, pranë kësaj Gjykate, t’u njoftojë shtetasit nën hetim K.I. dhe babait të tij, shtetasit D. I., vendimin e sekuestrimit.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në

Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda xxx.

U shpall sot në Tiranë, në datë 04.05.2015 ora 10.30.

SEKRETARE

Alma RAMAJ

GJYQTARE

Liljana BAKU